



KOMUNA E GJAKOVË

Nr. 01-060/01-23739

Datë.01.07.2019

PROCESVERBAL

Nga takimi i parë publik për vitin 2019 me qytetarët e Komunës së Gjakovës, të mbajtur me datën 01.07.2019, në sallën e Kuvendit të Komunës, me fillim në orën 11.00.

Të pranishëm në këtë takim publik ishin: Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardiq Gjini, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Anton Shala, Drejtorët e Drejtive Komunale, përfaqësues të OSBE-së, Zyrtarë Komunal, Zyrtarët për Informim, TV-Syri, Media të shkruara, si dhe afër pesëdhjetë(50) qytetarë të Komunës së Gjakovës.

Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardiq Gjini : Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale obligohemi që dy herë në vit të organizojmë debate publike me qytetarët e komunës së Gjakovës në mënyrë që të diskutojmë për çështjet që i preokupojnë qytetarët dhe që janë në interes të qytetarëve.

Nuk dua të zgjatem më shumë dhe të ju marr kohën tuaj por dua që të marr kërkesat, vërejtjet dhe sygjerimet e juaja dhe ju premtoj se do të trajtohen me seriozitet të gjitha. Andaj e hapi diskutimin dhe ju lutem të dilni në foltore dhe të prezantoheni .

z. Haxhi Tafoshi: Rruga "Lek Dukagjini"- Unë dua ta ngris shqetësimin tim për kanalizimin në rrugën Lek Dukagjini i cili që nga viti 2002 ka filluar dhe ende nuk është realizuar. Aty ka nevojë për intervenim emergjent sepse lagjia gjendet në një gjendje të mjerueshme nga ujërat e zeza.

Kryetari: Jemi në dijeni për atë problem dhe e kemi trajtuar atë çështje por ju them të drejtën në kanalizim në përgjithësi komuna e Gjakovës ka pasur ngecje, por tani ju premtoj se së shpejti do të rregullojmë edhe këtë çështje dhe do të intervenojmë në rrugën Lekë Dukagjini.

z. Valon Zherka: Bashkësia 1 lokale, për rrugën "Ibrahim Fehmiu" prapa shkollës fillore "Zekeria Rexha" mungon trotuari i cili është shumë i nevojshëm sidomos për nxënësit dhe ndriçimi. Çështja tjetër ka të bëjë me drejtorinë e shëndetësisë që ka

z. Isa Haxhikadrija: Rruga "14 Qershori", Kur është organizua aksioni "Ta pastrojmë Gjakovën" askush në rrugën tonë nuk ka ardhur të pastroj. Në rrugën tonë është një fabrikë për punimin e peletit dhe shkaktohet shumë zhurmë, pluhur dhe po erë shumë e keqe. Disa herë kemi kërkuar që të merren masa por deri më tanë, komuna nuk ka ndërmarrë asgjë andaj kërkoj nga ju z. Kryetar që të merrni masat e nevojshme.

Kryetari: Për aksionin "Ta pastrojmë Gjakovën" ka qenë aksion ku qytetarët kanë pastruar në lagjen e vet si dhe ka qenë një lloj gare. Ne do të dërgojmë inspektorët dhe personat përgjegjës të Urbanizmit dhe do të veprojmë në kuadër të normave të caktuara për këto raste.

Topalli: Fshati Kushavec - Në mbledhjen e Kuvendit u tha se rruga në fshatin Kushavec është paraparë që të shtrohet në vitin e ardhshëm andaj kërkoj që të shpejtohet sepse është një rrugë shumë e rëndësishme, gjithashtu kërkoj që rruga që ka filluar të realizohet ka disa ditë që nuk ka punuar askush aty dhe është paraparë në plan pesëdhjetë(50) ditë për tu realizuar pse aq shumë kur mundet të realizohet për 5 ditë? Ndërsa për sektorin e bujqësisë me rastin e grandeve të DZHE-së nuk jam përfshi sepse thonë jeni në sektorin e Bujqësisë dhe subvencionet që i jasin nuk bëjnë zhvillimin e bujqësisë sepse i përkrahni fermerët e vegjël dhe jo fermeri që me të vërtetë merret seriozisht me këtë veprimtari. Për grandet unë nuk mundem të merrem edhe me ketë çështje por nëse keni vërejtje bëni me shkrim dhe do të trajtohet me seriozitet.

Kryetari: Për rrugën Dol Kushavec afatet përcaktohen nga Operatorët dhe inxhinerët e komunës, ndërsa për pjesën e rrugëve në Kushavec kemi gjetur një buxhet që nuk ka qenë i mjaftueshëm as të prokurohen ato rrugë, andaj kemi buxhet dhe në vitin e ardhshëm do të rregullohen ato rrugë.

z. Xhavit Alijaj: Bashkësia Lokale Dujakë - fillimi shët e përgëzoj Komunën në krye me Kryetarin z. Ardian Gjini për punën që është duke e bërë. Në fshatin Dujakë kemi nevojë për kanalizim, për ndriçimin e rrugëve dhe për trotuaret për nxënës, sidomos në lagjen Alijaj është emergjente intervenimi për kanalizim. Në fshatrat Dobrigje dhe Firaj mungojnë kanalizimi, ndriçimi dhe trotuaret. Në fshatin Hereq kisha kërkuar që të intervenoj inspektorati i komunës që të bëjë largimin e telave që është tentuar të ngritet muri përballë shkollës Dëshmorët e Hereqit. Gjithashtu mungon kanalizimi në objektin e shkollës, kanalizimi në pjesën e lagjeve Thaqi tek pakicat si dhe tek familja Bajraktari si dhe trotuari i cili është i domosdoshëm.

z. Ramë Tali: E përshëndes kryetarin dhe që njëzet(20) vite nuk është punuar sa po punohet në këtë vit andaj unë po shfrytëzoj rastin të ju përgëzoj dhe të ju uroj punë të mbarë.

z. Mikel Maksuti: Unë kam disa kërkesa fillimisht për rrugën për Qafë të Prushit për Urën e Zojës, si dhe për rrugët e fshatit Vogovë që nuk janë ndërtuar. Kërkoj që kur të filloni të punoni në këtë fshat, ti shtronni të gjitha rrugët dhe mos ta ndjen veten asnjë banor i lënë anash. Ndërsa nga fshati Zylfaj deri në fshatin Brekoc asnjë njëri nuk është i punësuar në administratën e komunës andaj kërkoj që të kihen parasysh që të paktën nga një në fshat të punësohet. Ndërsa mbi fshatin Zhub është një deponi e mbeturinave andaj kërkoj që të dilni në teren dhe ti shikoni situatën.

Kryetari: Rruja për Zhub do të shikojmë me drejtorinë për Shërbime Publike që të vendosen tabelat si dhe do ti dërgojmë ekspertët e drejtorisë për Shërbime Publike dhe të shikojmë se ku qëndron problemi me atë urë. Për rrugët e fshatit Vogovë, në vitin e kaluar janë ndërtuar 44 KM rrugë të fshatrave. Për këtë vit shpresojmë që të dalim me mbi 100 km, por demokracia thotë se duhet të shkojmë në të gjitha pjesët e komunës në qytet e në fshat dhe rrugët do të kryhen të gjitha në këtë mandat por, nevojitet edhe ndihma e të gjithëve në mënyrë që të kryhen më shpejtë. Për punësimet, 300 punëtor i ka Komuna e Gjakovës nuk ka më shumë dhe nuk konsiderohen të papunë ata që punojnë privat. Për deponinë e inerteve do ti dërgojmë inspektorët, por aty është deponi e inerteve e jo e mbeturinave të përditshme dhe komuna nuk ka mundësi të i mbikëqyr vazhdimisht por duhet të interesohen edhe qytetarët për këtë temë.

z. Xhavit Alijaj: Për rrugën e fshatit Bitesh kemi pyetje se a ka hyrë në buxhet ndërtimi i asaj rruje apo si është puna?

Kryetari: Nuk do të shkoj të kërkoj asnjë votë nëse nuk ndërtohet ajo rruja.

z. Sadri Kovaqi: Unë e kam djalin me probleme shëndetësore, vet jam i sëmurë edhe gruaja ime është gjithashtu e sëmurë. Kam kërkuar nga Drejtoresha e Shëndetësisë por nuk kam përfituar nga subvencionet për Shëndetësi, që nga paslufta unë kam qenë përfitues i ndihmave nga Kryqi i Kuq por që dy vite nuk kam përfituar asgjë dhe kam shumë nevojë për ndihmë.

Znj. Adelina Shehu Kolaj: Në thirrjen Publike janë të specifikuara për cilat raste mund të ndahen ato mjete dhe sa i përket këtij rasti ju lutem që ta bëni një kërkesë me shkrim dhe ne do të ju përkrahim.

Kryetari : Për këto raste ju lutem bëjeni kërkesën dhe do të ju ndihmojmë brenda mundësive që i kemi.


Unë ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrje në këtë debat dhe kërkoj nga të gjithë qytetarët dhe posaçërisht kryetarët e Bashkësive Lokale që të ndihmojnë në të gjitha drejtimet dhe të përkrahin komunën në zhvillimin e projekteve që janë në interes të qytetarëve dhe ne nuk do të ndalemi duke u përpjekur që të punojmë sa më shumë dhe sa më fer dhe me të drejtë si në zhvillimin e projekteve, ashtu në

ndarjen e grandeve dhe të subvencioneve dhe në të gjithë sektorët. Unë kam mandat edhe dy vite e gjysmë dhe do ti realizoj të gjitha premtimet, brenda mundësive do të bëjmë më të mirën e mundshme.


Duke përmbyllur debatin, Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini i falenderoi të gjithë qytetarët të cilët morën pjesë në këtë debat publik.

Takimi publik përfundoi në orën 12:30.

Procesmbajtës


Burim Bajrami




z. Ardian Gjini